




KTHIMI I ROBOTIT NË FILLIMET E LOJËRAVE OLIMPIKE

TEMA: Roboti micro:Maqueen Plus po udhëton në kohë për të zbuluar historinë e lojërave të para olimpike, të cilat kanë filluar në Greqinë e lashtë. Gjatë rrugëtimit të tij, roboti do të mësojë rreth sporteve të zhvilluara si: vrapimi, gjimnastika, gara me kuaj, lundrimi dhe judo-ja.

Gjatë eksplorimit, roboti është i interesuar edhe mbi teknologjinë dhe kështu do të njihet me aparatën fotografikë të quajtur "Kirby", një teknologji e përdorur për fotografimin e atletëve pranë vijës së finishit.



Përpara se roboti të fillojë ekzekutimin e sfidës, duhet të vendoset në segmentin për kalibrim, ashtu siç tregohet në figurë dhe të kalibrohet.

Më pas, roboti duhet të vendoset mbi segmentin me numër '1' (para vijës së kuqe), ashtu siç tregohet në figurë.

Në gjendjen POWER ON roboti duhet t'i ketë të gjitha diodat e fikura.

Për të nisur robotin, duhet të shtypni butonin 'B', në pllakën micro:bit.

Pasi të shtypni butonin 'B', roboti ndez të gjitha diodat RGB në ngjyrë të kaltër. Po ashtu, roboti menjëherë ndez edhe LED diodat.

*Të gjitha diodat RGB në ngjyrë të kaltër dhe LED diodat, roboti duhet të i mbajë të ndezura nga segmenti me numër '1' deri te segmenti me numër '14'.

Menjëherë pas ndezjes së diodave RGB dhe LED diodave, roboti gjen vijën e zezë dhe fillon ndjekjen e saj me anë të sensorit për ndjekjen e vijës (Line Tracking Sensor).

*Roboti duhet të ndjekë vijën e zezë nga segmenti me numër '1' deri te segmenti me numër '14'.

Kur roboti arrin në segmentin me numër '14', roboti ndalet me të tre rrotat brenda segmentit.

Roboti ndalet duke aktivizuar sensorin e distancës (Ultrasonic Sensor) me anë të një kutie që vendoset ashtu siç tregohet në figurë. Menjëherë sapo të ndalet, roboti fik të gjitha diodat RGB dhe LED diodat. Sapo të fik diodat, roboti luan melodinë e plotë 'RINGTONE'.

K
U
T
I
A

